

VENDIM
Nr. 760, datë 20.12.2023

**PËR MIRATIMIN E LETËRMARRËVESHJES NDRYSHUESE TË
MARRËVESHJES SË HUAS (NR. ABA-P3, DATË 30 QERSHOR 2008), NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR (TË ZËVENDËSUAR NGA
AGJENCIA JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR, NË TETOR
2008), PËR PROJEKTIN “PËRMIRËSIMI I SISTEMIT TË KANALIZIMEVE PËR
TIRANËN E MADHE”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 9964, DATË 24.7.2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e letërmarrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas (nr. ABA-P3, datë 30 qershor 2008), ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (të zëvendësuar nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, në tetor 2008), për projektin “Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e Madhe”, ratifikuar me ligjin nr. 9964, datë 24.7.2008, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Agjencia për Bashkëpunim Ndërkombëtar Japonez

Nibancho, Godina Qendrore

5-25, Niban-cho, Chiyoda-ku, Tokyo 102-8012, Japoni

Datë: 10 maj 2023

Ref Nr. JICA (7R) 202305100001

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Bulevardi Dëshmorët e Kombit Nr:3 Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të: Sh.S. Z. Ervin Mete

Ministre e Financave dhe Ekonomisë, Republika e Shqipërisë

Marrëveshja e Huasë Nr. ABA-P3, datë 30 qershor 2008, për Projektin “Përmirësimi i Sistemit të Kanalizimeve në Tiranën e Madhe”

Në referencë të letrës suaj nr. 23442/4 prot. të datës 20 mars 2023 dhe Notës Verbale Nr. 024/2023, datë 19 prill 2023 të Ambasadës së Japonisë në Republikën e Shqipërisë drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e cila duke shprehur pëlqimin e Qeverisë Japoneze për kërkesën e Republikës së Shqipërisë për zgjatjen e periudhës së disbursimit të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huasë, me anë të kësaj biem dakord si më poshtë:

1. Seksioni 2 (2) i Nenit I të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huasë, ndryshohet si më poshtë:
“ Disbursimi përfundimtar sipas Marrëveshjes së Huasë do të kryhet jo më vonë se data 24 tetor 2026 dhe pas kësaj date nga ana e JICA-s nuk do të kryhet asnjë disbursim i mëtejshëm, përveç kur bihet dakord ndërmjet JICA-s dhe Huamarrësit.”
2. Ky ndryshim hyn në fuqi nga data kur JICA njoftohet se kanë përfunduar procedurat e nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Huasë së lartpërmendur në Republikën e Shqipërisë.
3. Kjo letër nuk do të interpretohet për të autorizuar ndonjë ndryshim tjetër përveç atij të përmendur më lart.

Në momentin e përfundimit të procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së lartpërmendur të Huasë në Republikën e Shqipërisë, ju lutem konfirmoni miratimin tuaj për amendimin e mësipërm duke nënshkruar atë dhe kopjen bashkëlidhur kësaj shkrese, duke ruajtur një kopje tuajën dhe duke na kthyer kopjen tjetër.

Me respekt,

Nga: Nënshkrimi
MATSUNAGA Hideki
Drejtore i Përgjithshëm,
Departamenti i Lindjes së Mesme dhe Evropës
Agjencia për Bashkëpunim Ndërkombëtar Japonez

Konfirmuar:

Në datën 08.11.2023

Për: MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nga: MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ERVIN METE

Në vëmendje të: Përfaqësuesit Kryesor, Zyra Ballkanike JICA